

VENDIM
Nr. 503, datë 27.7.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË
DHE SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 245 913 398 (dyqind e dyzet e pesë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 72 409 932 (shtatëdhjetë e dy milionë e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Vorë, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak, në masën 73 503 466 (shtatëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak, në masën 147 548 038 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, sipas aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 43 445 959 (dyzet e tre milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Vorë i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë, pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 44 102 079 (dyzet e katër milionë e njëqind e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, pa TVSH.

3. Efekti financiar, për vitin 2022, përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet bashkive Durrës, Vorë dhe Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj